REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4495/13 prot. Gramsh, më 02 /11 /2026

VENDIM

Nr. 85 , datë 30.10.2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE QË NJIHEN SI "POSEDUES JOPRONARË", NË KUADËR TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 20/2025, "PËR PAKETËN E MALEVE"

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; të neneve 3, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Ligjit nr. 20/2025, "Për Paketën e Maleve"; të Udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive"; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 238, datë 01.04.2026, "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Gramsh"; si dhe të relacionit shpjegues të paraqitur nga Bashkia Gramsh,**Këshilli Bashkiak Gramsh:**

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të subjekteve që njihen si "posedues jopronarë", në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 20/2025, "Për Paketën e Maleve", sipas tabelës përmbledhëse bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban të dhënat identifikuese të subjekteve, vendndodhjen e pasurive, numrat e planeve, numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse.
2. Ngarkohet Bashkia Gramsh, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, për ndjekjen dhe përfundimin e procedurave të mëtejshme administrative pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe institucioneve të tjera kompetente, sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 3, të Ligjit nr. 20/2025 dhe legjislacionit në fuqi.
3. Njohja e subjekteve si "posedues jopronarë", sipas këtij vendimi, nuk përbën në vetvete kalim të pronësisë mbi pasuritë përkatëse. Procedurat për kalimin e pronësisë ndiqen në

përputhje me kërkesat, kushtet dhe procedurat e mëtejshme të parashikuara në Ligjin nr. 20/2025 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe strukturat përgjegjëse të administratës së Bashkisë Gramsh.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Sekretari i këshillit

Xhulia Gjini

Kryetari i Këshillit

Luljeta Dollani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH